



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

AC.nr.6622//21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Besnik Bislimaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.A. nga Gj., kundër të paditurës R. B.me seli në P. në çështjen juridike kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesave të ushtruara nga paditësi kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 105/19, të datës 06.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **20.05.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e paditësit J.A. nga Gj. ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.105/19, dt: 06.05.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithshëm me aktgjykimin C.nr. 105/19, të datës 06.05.2021, ka vendosur si në vijim:

I.REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit J. A. nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura R. B.me seli në P., që paditësit ti kthehet shuma totale prej 631 euro për vitin 2016, si dhe në emërtë kompensimit të dëmit jo material ti paguhet shuma prej 78 euro në muaj duke filluar nga muaji Korrik i vitit 2016 e tutje, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës, është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e saj të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka ushtruar paditësi J.A.nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke e kundërshtuar në tërësi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që e njëjta ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën ta kthej në ri gjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo të njëjtin ta aprovoj dhe ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar nga pala e paditur.

Gjykata e Apelit, si gjykatë ankimore, pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve ankimore, vlerësimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) në lidhje me nenin 200 të LPK-së, konstatoi se:

Ankesa e paditësit J.A. nga Gj., është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi J.A. nga Gj.me datën 06.02.2019, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës R. B. me seli në P., dhe me precizimin e padisë ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të dëmit për vitin 2016, e paditura t'ia paguajë shumën prej 631 euro, si dhe në emër të kompensimit për dëmin jo material t'ia paguajë shumën prej 78 euro në muaj, duke filluar nga muaji Korrik i vitit 2016 e tutje, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura në përgjigje në padi dhe në seancat e shqyrtimeve gjyqësore e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimins e e paditura ka bërë bllokimin e llogarisë së paditësit në bazë të marrëveshjes së kredisë që paditësi ka lidhur me të paditurën të datës 23.10.2012, ashtu që, me mos përmbushjen e detyrimit nga kredia, e paditura si kreditore ka vepruar në procedurën e përmbarrimit duke ekzekutuar mjetet sipas marrëveshjes mbi kredinë dhe borxhin që ka qenë evident në rastin konkret, mbi bazën e të gjitha këtyre arsyeve, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas nxjerrjes dhe administrimit të provave, mbajtjes së seancave gjyqësore, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga plani I amortizimit të kredisë e llogaritur ne daten e dispursimit e datës 05.06.2008 prej vitit 2008 deri në vitin 2011, gjykata vërtetoi faktin se I njëjti këtë shumë të kredisë në vleren prej 5,000.00 E e kishte paguar në mënyrë të rregullt ngase kishte qenë në mardhënje pune.

Nga plani i amortizimit të kredisë e llogaritur në datën e dispursimit e datës 05.06.2008 prej vitit 2011 deri në vitin 2012, gjykata provoi faktin se edhe këtë kredi paditësi e kishte paguar në mënyrë të rregullt dhe nuk kishte pasur vonesa.

Nga ,marrëveshja mbi kredinë personale në R. B. me seli në P dhe paditësit J. A. nga Gj., në bazë të pagës së tij në shumë prej 365.00E

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate ,në rastin konkret ,nuk ka qenë kontestues fakti se me datën 23 tetor 2012 është arritur marrëveshja mbi kredinë nr.XXXX në shumë prej 5.400.00E në afat të kthimit prej 74 muajve dhe deri në daljen e paditësit në pension nuk ka patur asnjë vones lidhur me kthimin e kredisë, pork a qenë fakti se të njëjtin në momentin e daljes së tij në pension kanë filluar t'ia paraqiten problemet financiare ashtu që ka ardhur deri tek vonesa e kësteve të kredisë dhe i njëjti nuk ka mundur ti kthejë me kohë këstet e kredisë.

Gjykata ka çmuar se kërkesëpadia e paditësit nuk e ka themelësin në prova materiale , me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar baza juridike dhe aq më pak lartësia e kërkesëpadisë. Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë të vetme me të cilën do të vërtetohej themelësia e kërkesëpadisë së paditësit , pasi që në rastin konkret edhe pse gjykata ex office paditësit I ofroj nxjerrjen e ekspertizes financiare dhe e obligon të njëjtin që të paguaj shumën prej 150.00E, në emër të pagesës së ekspertizës, I njëjti këtë nuk e kishte bërë duke aloduar se vetë mund ta llogarisë këtë shumë. Gjykata vlerëson se shkaktimi I dëmit është kushti me rëndësi për lindjen

e detyrimeve për shpërblim. Ai është vendimtarë për krijimin e përgjegjësive juridike civile për dëmin e shkaktuar, sepse rreth tij sillen dhe rezultojnë të gjitha kushtet e tjera që kanë të bëjnë me këtë përgjegjësi. Shkaktimi i dëmit, si fakte juridik ,paraqet rrethana të caktuara e cila sjell deri të krijimi, ndryshimi apo ndërprerja e marrëdhënies se detyrimeve, ndërsa në rastin konkret shtrihet pyetja me çka është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit dhe me cilat prova është vërtetuar lartësia e sajë pasi që i njëjti këtë shumë të hollav në lartësinë e lartëcekur e kishte marrur me kohë , dhe i njëjti deri në momentin e daljes në pension në mënyrë të rregullt kishte paguar këstet e kredisë dhe në momentin e pensionimit nuk kishte mundësi financiare për pagesën e borxhit dhe në rastin konkret kemi edhe vendimin e Gjykatës së Apelit AC.nr.211/17 të dt.09.08.2019 me të cilin është refuzuar ankesa e tij në cilësinë të debitorit andaj këto prova nuk ishin të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse andaj, gjykata ka vendosur që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit se si të pabazuar në mungesë të provave.

Gjithashtu duke u bazuar në nenin 319.1 dhe nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, ku neni 319.1 ka paraparë *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Kurse neni 322.1 ka paraparë *“në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 I këtij ligji)nuk mund të konstatoj me siguri ndonjë fakt, për egzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*. Ndërsa neni 322.2 ka paraparë *“pala që pretendonë se I takon një e drejtë ka për detyrë ta provoj faktin që është qenësore për krijin ose realizimin e saj po që se ligji nuk parasheh diçka tjetër”*. Andaj vendosi dsi në pikën 1 të dispozitivit.

Gjykata i ka vlerësuar dhe provat tjera materiale të cialt gjenden në shkresat e lëndës por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosje meritore të kësaj çështje juridiko kontestimore.

Vensimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e neneve 450 të LPK-së ku secila palë është e obliguar t'i bartë shpenzimet e tyre të krijuara në raport me këtë contest civil.

Në arsyet e cekura me lartë dhe bazuar në dispozitat e nenit 253 par.1 pika c)dhe 319.1 dhe 322.1 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të kërrij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe as shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, pika n) të pretenduara nga pala ankuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve ankimore të të paditurës, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n), ngase nga nga përmbajtja dhe struktura e

aktgjykimit të ankimuar, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka harmonizuar në tërësi përmbajtjen si në pikën I, II, IV dhe V të dispozitivit dhe se e njëjta ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare të cilat kanë rezultuar me aprovimin e kërkesëpadisë si në pikat e atakuara me ankesë, prandaj, ky pretendim ankimor rezulton i pa bazuar.

Të pa bazuara, rezultojnë edhe pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me vërtetimin e jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, për faktin se ashtu siç ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar nga provat e administruara në këtë çështje juridike, rezulton se se me datën 23 tetor 2012 është arritur marrëveshja mbi kreditë nr.120236857 në shumë prej 5.400.00E në afat të kthimit prej 74 muajve dhe deri në daljen e paditësit në pension nuk ka patur asnjë vones lidhur me kthimin e kredisë, por ka qenë fakti se të njëjtin në momentin e daljes së tij në pension kanë filluar t'i paraqiten problemet financiare ashtu që ka ardhur deri tek vonesa e kësteve të kredisë dhe i njëjti nuk ka mundur ti kthejë me kohë këstet e kredisë, dhe rrjedhimisht në rastin konkret nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit dhe rrjedhimisht nuk është vërtetuar lartësia e saj pasi që i njëjti këtë shumë të hollave në lartësinë e lartëcekur e kishte marrur me kohë, dhe i njëjti deri në momentin e daljes në pension në mënyrë të rregullt kishta paguar këstet e kredisë dhe në momentin e pensionimit nuk kishte mundësi financiare për pagesën e borgjit dhe në rastin konkret kemi edhe vendimin e Gjykatës së Apelit AC.nr.211/17 të dt.09.08.2019 me të cilin është refuzuar ankesa e tij në cilësinë të debitorit andaj këto prova nuk ishin të mjaftushme për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse andaj, gjykata ka vendosur që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit se si të pabazuar në mungesë të provave, prandaj, nisur nga gjendja e vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë, të cilën gjendje e pranon në tërësi edhe gjykata e shkallës së dytë, rrjedh se e paditura me asnjë veprim të saj nuk i ka shkaktuar dëm të natyrës materiale apo jo materiale paditësit, dhe referuar nenit 136 dhe 137 si dhe nenit 183 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyreimeve nr. 04/L-077, e paditura nuk e ka detyrim që paditësit t'ia kthej shumën prej 631 euro në emër të dëmit material të pretenduar nga pala paditëse si rrjedhojë e përmbushjes së kredisë nga ana e tij, dhe gjithashtu nuk e ka detyrim që të paguaj dëm të natyrës materiale në shumë mujore prej 78 euro nga muaji Korrik i vitit 2016 e tutje, prandaj, pretendimet e paditësit në rastin konkret rezultojnë të pa bazuara dhe pa argumentuara dhe si të tilla refuzohen.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me shpenzimet e procedurs, është në përputhje me nenin 450 të LPK-së, ashtu që, e paditura përderisa nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, duke marrë për bazë suksesin e paditësit të arritur në procedurë, drejtë është vendosë që secila palë ti bartë shpenzimet e saj të procedurës.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 6622/2021, data 20.05.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka